



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1100/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Lirije Luta, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**I. Pranohet pjesërisht** i bazuar apeli Anr.1100/2021, të datës 08.11.2021 paraqitur nga Lirije Luta, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilin kërkon rinumërimin në vendvotimin 0715D/01D.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Kaçanikut, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës në Komunën e Kaçanikut, në vendvotimin 0715D/01D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet e vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

**IV. Refuzohet e pabazuar** pjesa e apelit e paraqitur nga Lirije Luta, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen

e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilin kërkon rinumërimin në vendvotimet 0702D/01R, 0702D/02D, 0704D/01R, 0704D/02D.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1100/2021, (përmes postës të datës 04.11.2021), të paraqitur nga Lirije Luta, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, me të cilën ndër të tjera pretendon se në vendvotimet 0702D/01R, 0702D/02D, 0704D/01R, 0704D/02D, 0715D/01D, ka pasur parregullsi në formularë, pasi që ka mospërputhje të rezultateve nga lista e rezultateve të KQZ-së. Apelit i ka bashkangjitur 2 deklaratë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryera nga vet PZAP, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është pjesërisht i bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Lirije Luta, kandidat për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Kaçanikut, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet e lartcekura. PZAP, pas shqyrtimit të pretendimeve në shkresat e lëndës gjeti se apeli është pjesërisht i bazuar. Në rastin konkret për vendvotimin 0715D/01D, në Komunën e Kaçanikut, paneli gjeti se ka mospërputhje të rezultateve të publikuara nga ana e KQZ-së, pasi që kandidati në fjalë ka gjithsej zero (0) vota, ndërsa si dëshmi ka bashkangjitur 2 deklaratë të votuesve që deklarojnë se kanë votuar kandidaten Lirije Luta, për këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon

integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim të kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur, si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, sa i përket vendvotimeve 0702D/01R, 0702D/02D, 0704D/01R, 0704D/02D, sepse për këto vendvotime nuk ka bashkangjitur asnjë deklaratë apo provë tjetër që do të dëshmonte se ka parregullsi. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, pretendimet e saj mbeten vetëm në suaza të dyshimeve. Pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.1100/2021 më datën 09.11.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.